



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

Nr. Prot

Dt. . . 2019

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

ARTUR BARDHI

RELACION TEKNIK

Qyteti i Laçit ka nje popullsi mbi 30.000 banore dhe ndodhet ne nje lartesi 20 m mbi nivelin e detit, me klime mesdhetare, me temperatura mesatare me te ulta -5 °C ne dimer (janar) dhe me nje mesatare shumevjeçare me te larte +38 °C ne vere (korrik).

Qyteti dhe qytetaret kane nje tradite te mire per mirembajtjen dhe zhvillimin e dekorit ne fushen e gjelberimit, megjithese kerkohet nje kujdesje dhe ruajtje e veçante, ne keto kushte te rritjes se popullsise dhe zhvillimit ekonomiko-kulturor ne kete treve.

Per arsyet e nevojat e ruajtjes, mirembajtjes dhe zhvillimit te gjelberimit ne qytetin e Laçit duke qene se ky aktivitet ka kaluar tashme me sipermarrje private , vetem per qytetin tone Bashkia Laç po harton dhe do te kryeje prokurimin e fondevit perkatese per periudhen shkurt 2019- shkurt 2024 me sipermarrje.

Per realizimin e detyres se ketij projekti te mirembajtjes dhe shtimit te siperfaqeve te gjelberta nepermjet sherbimit te gjelberimit Bashkia Laç ka percaktuar nje fond, nepermjet te cilit do te kryhen volume punimesh te caktuara dhe do te beje te mundur realizimin e detyres se caktuar.

Meqenese ka perfunduar afati i kontrates se pare te sipermarresit jane kryer inventaret e siperfaqeve te gjelberimit, dhe jane percaktuar volumet e punes per çdo ze punimi qe do te mundesoje zhvillimin, ruajtjen, shtimin dhe mirembajtjen e gjelberimit.

Per kryerjen e sherbimit ne teresi dhe sa me cilesor Jane perllogaritur te gjitha analizat e çmimeve per çdo ze punimi.

Aktiviteti i mirembajtjes dhe zhvillimit te gjelberimit te qytetit permban si kerkesa kryesore imediate sherbimet e gjelberimit, sherbimet agroteknike ne siperfaqet me lule, ne siperfaqet me bar, ne druret dekorative, ne shkurret dekorative, ne bordurat e gjelberimit, rruge dhe sheshe, furnizim dhe vendosje stolash, mbjelljen e pemave te reja dekorative etj.

Sipermarresi do te kontrolloje te gjitha mbjelljet ne te gjitha strukturat siç Jane: druret, shkurret, siperfaqet me bar natyral dhe te kultivuar, siperfaqet me lule, bordurat e gjelberta, cilesine e fidaneve qe do te mbillen. Do te marre ne dorezim te gjithe inventarin e deritanishem dhe do te pergjigjet per ruajtjen dhe sherbimin e te gjithe infrastrukturese se gjelberimit te qytetit, duke vene ne dispozicion te gjithe mekanizmat e sherbimit te planifikuar.

Lista e mjeteve te domosdoshme perfshihet e veçante ne kushtet e domosdoshme te vleresimit te subjektit fitues.

Nje kujdes me i madh ne fushen e gjelberimit te qytetit te Laçit duhet t'i kushtohet siperfaqeve me lule dhe drureve dekorative duke siguruar ruajtjen dhe shtimin e tyre me zevendesimet eventuale siç Jane edhe planifikuar.

Vemendje e veçante duhet te kushtohet nga sipermarresi gjate periudhes se veres ne kulmin e temperaturave te medha duke siguruar ujin per vaditje te siperfaqeve te gjelberimit.

Sipermarresi (subjekti fitues) do te garantoje vaditjen e drureve rrugore te rinj deri ne tre vjet pas sezonit te mbjelljes si dhe siperfaqet me lule qe nuk kapen nga rrjetet e ndryshme te furnizimit me uje me ane te autoboteve.

Subjekti do te marre ne dorezim me inventar te gjithe fondin bimor te drureve shkurreve etj. dhe do te garantoje ruajtjen e tyre.

Per çdo demtim jo per arsyen sherbimi subjekti duhet te mbaje proces-verbalet perkatese konform

ligjit dhe akteve te K.B.Laç dhe te informoje menjehere Bashkine (Sektorin e Sherbimeve Publike).

Per te gjitha demtimet per shkak te moskryerjes se sherbimeve, subjekti do te ngarkohet me perjegjesi materiale nga Bashkia (Supervizori) dhe do te beje zevendesimet eventuale me shpenzimet perkatese ne kohen e percaktuar.

Aktiviteti i ruajtjes, shtimit dhe mirembajtjes se gjelberimit eshte i percaktuar dhe i jepet sipas inventarit qe i bashkengjit projektit.

Per çdo mungese qe mund te rezultoje ne inventar subjekti duhet te kundershtoje qe ne fillim te aktivitetit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Per te realizuar sherbimin e ruajtjes, mirembajtjes dhe zhvillimin e gjelberimit ne qytetin e Laçit jane percaktuar specifikime teknike kryesore gjate kryerjes se punimeve.

PASTRIMI ME KREHER NGA MBETJET URBANE

Kryhet çdo dite gjate gjithe vitit ne ditet e punes te planifikuara. Gjate periudhes se veres mund te realizohen dhe volume pune te tjera per te perballuar ndotjet e stines edhe ne turnet e dyta.

Pastrimi me kreher do te relizohet kryesisht ne siperfaqet e barit dhe me lule si dhe ne buze te bordurave te gjelberta dhe poshte drureve halore .

Pastrimi i gjetheve ne sip.e barit dhe luleve do te relizohet me fshese dhe kreher.

VADITJA

Do te realizohet pas mbjelljes se siperfaqeve te barit, luleve, drureve dekorative, shkurreve dekorative dhe bordurat e gjelberta, gjithashtu vaditja do te realizohet ne sherbime gjate veres, por ne raste te vecanta edhe ne stine te tjera. Sasia e ujit do te jete jo me pak se 20 litra/m² ne sip.barit, luleve dhe jo me pak se 30 litra per 1 rrjenje ne druret dhe shkurret dekorative.

KOSITJA E BARIT

Eshte nje operacion sezonal, fillon ne prill dhe perfundon ne tetor jo me pak se 6 here. Sip. e barit do te kositen me makina- moto ose elektrokorrese.

KRASITJA DHE TRAJTIMI I KURORAVE

Realizohet tek druret, shkurret dhe bordurat e gjelberta. Druret dhe shkurret krasiten duke filluar nga muaji dhjetor e ne vazhdim. Druret gjetherenes perfundojne krasitjen ne fillim te muajit mars, kurse ato gjethembajtes krasiten ne çdo kohe dhe 2 here ne vit, forma e kurorave te tyre te jete ne formen gjeometrike te kerkuar.

Bordurat dhe shkurret e llojit ligustrum dhe oleander krasiten thuajse çdo muaj duke filluar nga muaji prill e deri ne muajin tetor te çdo viti kalendarik.

Per druret do te aplikohen sipas preventivit te percaktuar krasitje te renda dhe krasitje te lehta, per dhenien e formes se kerkuar ne varesi te rruges dhe pamjes arkitektonike te pallateve.

Subjekti fitues dhe mbikqyresi i sherbimit do te beje njoftimet perkatese per demtimet qe realizohen ne kete fushe ne kohen e duhur prane Sektorit te Sherbimeve Publike ne Bashki.

Te gjithe punonjesit prane ketij aktiviteti te sipermarresit jane perqiegjes material dhe kane perqiegjesi financiare para administratorit ne kuadrin e ruajtjes te te gjithe pasurise se sip.te gjelbra. Personeli duhet te jete i veshur me uniforme gjate gjithe kohes se punes.

Eshte bere perllogaritja e nr. te nevojshem te punetoreve pas çdo analize te çmimit te zerit perkates per gjithe volumin e punimeve te vtitit kalendarik ose sezonal.

Per llogaritjen e fuqise punetore eshte perdonur metoda e pjestimit te sasise se punimeve vjetore sipas zerave analitike dhe normes per çdo njesi.

PAGESAT E PUNIMEVE TE KRYERA. SITUACIONET.

Pagesat e punimeve (situacionet) te realizuara kryhen nepermjet volumit te punimeve te reflektuara ne proces-verbalet te pjesshme, ditore, javore, mujore, te mbajtura ndermjet perfaquesuesit te subjektit (sipermarresit) dhe mbikqyresit (supervizorit) te Bashkise duke llogaritur me çmimet e preventivave te fituar me tender per çdo ze punimi sezonal, te cilat jane

te specifikuara ne preventivat perkates. Pagesat ndryshojne nga muaji ne muaj sipas sherbimeve qe do te kryhen ne periudhat e percaktuara ne preventive.

Te gjitha punimet e realizuara shprehen ne situacione mujore (financiare) te firmosura nga subjekti sipermarres dhe mbikqyresi (supervizori i Bashkise).

Ne raste kur krijohen dhe evidentohen demtime ne siperfaqe te gjelbera per arsyet e moskryerjes se sherbimeve ne kohen e duhur, mbikqyresi i punimeve ne baze te process-verbaleve te mbajtura llogarit vleren e demit te kriuar dhe ben zbritjen ne situacionin perkates.

Subjekti nuk duhet te tejkaloje fondin vjetor te sherbimit per çdo ze punimi.

Per çdo ndryshim te volumit te punimeve apo te rritjes ose zvogelimit te inventareve dhe per çdo ndryshim te pages minimale nga shteti, behen edhe ndryshimet ne preventive, rrjedhimisht ne llogaritjen e fondeve vjetore dhe pagesat ne situacione.

Standartet e bimeve dhe llojet qe do te pranohen nga sipermarresi per mbjelljet ne te gjitha strukturat do te percaktohen ne aneks kontraten.

Gjithashtu ne aneks kontrate do te percaktohen standartet e dekorit dhe te paraqitjes pas punimeve dhe nevojave per nderhyrje per punime ne te gjitha strukturat e aktivitetit te mirembajtjes ne siperfaqe te gjelberta, siperfaqe bari, lulesh, krasitje druresh e shkurresh dekorative etj.

Per gjelberimin e qytetit jane parashikuar keto volume vjetore:

| | | |
|----------------------------------|----------------|--------|
| 1. mirëmbajtje lule | m ² | 700 |
| 2. mirëmbajtje bar I kultivuar | m ² | 4,000 |
| 3. mirëmbajtje bar natyral | m ² | 25,066 |
| 4. mirëmbajtje dru dekorativ | rrënje | 2,596 |
| 5. mirëmbajtje shkurre dekorativ | rrënje | 4,184 |
| 6. mirëmbajtje ligustre | ml | 3,440 |

| | | |
|---------------------------------|----------------|-------|
| 7. mirëmbajtje rruge dhe sheshe | m ² | 6,400 |
| 8. prodhim vendosje stolash | copë | 50 |

Ne zerin “**Mirembajtje lule**” jane parashikuar ne çmim, fare lule per mbjellje kg. 5, pleh organik kv.20, pleh kimik kv.2, pesticide kg.1.5, uje m³ 100, rroba pune pale 1, vegla pune cope 1,tub gome ml.30, dite pune 105.25

Ne zerin “**Mirembajtje bar i kultivuar**” jane parashikuar ne çmim, fare bari per mbjellje kg.15, pleh organik kv.25, pleh kimik kv.2, nitrat kv.1, uje m³ 150, rroba pune pale 1, vegla pune cope 3, tub gome ml. 30, dite pune 218.

Ne zerin “**Mirembajtje bar natyral**” jane parashikuar ne çmim, rroba pune pale 3, vegla pune cope 9, dite pune 827.

Ne zerin “**Mirembajtje drure dekorativ**” jane parashikuar ne çmim, blerje fidani rrenje 200, pleh kimik kv 1, pesticide kg 30, gelqere kv 3, ristela pishe m³ 5, rroba pune pale 3, vegla pune cope 9, dite pune 570.9.

Ne zerin “**Mirembajtje shkurre dekorative**” jane parashikuar ne çmim , blerje fidani rrenje 500, pleh kimik kv 2, uje m³ 50, rroba pune pale 1, vegla pune cope 3, tub gome ml. 50, dite pune 381.6.

Ne zerin “**Mirembajtje ligustre**” jane parashikuar ne çmim, blerje fidani rrenje 240, pleh kimik kv.2, uje m³ 50, rroba pune pale 1, vegla pune cope 3, tub gome ml. 50, dite pune 368.1.

Ne zerin ”**Mirembajtje rruge e sheshe**” jane parashikuar ne çmim, rroba pune pale 2, vegla pune cope 6, si dhe dite pune 826.6.

Ne zerin ”**Prodhim stoli**” jane parashikuar ne çmim, blerje materialesh ,boje, energji elektrike dite pune.

SPECIFIKUESIT: